

Sigurimi i të dhënave dhe njohurive për të arritur  
ambicet mjedisore dhe klimatike të Evropës

# Strategjia AEM-Eionet 2021-2030



Dizajni i kopertinës: PomilioBlumm  
Foto e kopertinës: PomilioBlumm  
Faqosja: PomilioBlumm - AEM

### Njoftim ligjor

Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionet zyrtare të Komisionit Evropian apo institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian. As Agjencia Evropiane e Mjedisit, as ndonjë person apo kompani që vepron në emër të Agjencisë nuk është përgjegjës për përdorimin e mundshëm të informacionit, që ky botim përmban

### Njoftim për të drejtën e autorit

© Agjencia Evropiane e Mjedisit, Riprodhimi i vitit 2021, është i autorizuar me kusht që të njihet burimi. Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2021

Më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian, është i disponueshëm në Internet. (<http://europa.eu>)

ISBN 978-92-9480-360-3  
doi: 10.2800/92395

## Rreth AEM dhe Eionet

Agjencia Evropiane e Mjedisit (AEM) është një agjenci e Bashkimit Evropian. Detyra jonë është që të sigurojmë informacione me baza të forta dhe të pavarura për mjedisin dhe klimën. Rregullorja për krijimin e AEM u miratua nga Bashkimi Evropian në vitin 1990 dhe Agjencia nisi aktivitetin e saj në Kopenhagen në vitin 1994. Sipas Rregullores së saj u themelua Rrjeti Evropian i Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor (Eionet). Eionet është një rrjet partneriteti i AEM-së dhe vendeve të saj anëtare dhe bashkëpunuese. Eionet gjithashtu përfshin Qendrat Evropiane Tematike – konsorciume të organizatave Evropiane me ekspertizë në fusha të caktuara mjedisore, duke mbështetur në këtë mënyrë, AEM dhe vendet anëtare të Eionet.

Për të mbështetur politikëbërjen në Evropë, ne punojmë ngushtësisht me institucionet kombëtare dhe Evropiane, në mënyrë të veçantë me Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Bashkimit Evropian.

[eea.europa.eu/about-us](http://eea.europa.eu/about-us)

Agjencia Evropiane e Mjedisit  
Kongens Nytorv 6  
1050 Kopenhagen K  
Danimarke

Tel: +45 33 36 71 00  
Web: [eea.europa.eu](http://eea.europa.eu)

Sigurimi i të dhënave dhe njohurive për të arritur  
ambicet mjedisore dhe klimatike të Evropës

# Strategjia AEM-Eionet 2021-2030



Ky dokument paraqet vizionin dhe objektivat strategjike që do të formesojnë punën e Agjencisë Evropiane të Mjedisit, Rrjetit Evropian të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor, në dekadat e ardhshme. Puna do të përqëndrohet në pesë fusha, të identifikuar në këtë dokument. Informacione më të detajuara mbi aktivitetet konkrete do të jepen në Dokumentat e Veçanta të Programimit.

# Agjencia Evropiane e Mjedisit dhe Rrjeti Evropian i Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor

## Sigurimi i njohurive të bazuara në prova mbi mjedisin dhe klimën e Evropës

### Rreth nesh

Agjencia Evropiane e Mjedisit (AEM) dhe Rrjeti Evropian i Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor (Eionet) kanë siguruar të dhëna dhe informacione mbi mjedisin dhe klimën e Evropës për qytetarët evropianë dhe politikëbërësit, që nga viti 1994. Sot rrjeti ynë i gjerë, lidh qindra institucione nga 38 vende anëtare dhe bashkëpunuese.

Baza e njohurive që kemi krijuar së bashku, është e gjerë, dhe fillon me matjet e cilësisë së ajrit, afërsisht në kohë reale në të gjithë Evropën, e më tej në dokumentimin e trendeve dhe projeksioneve të emetimeve të gazrave serë, sigurimin e të dhënave satelitore të mbulesës së tokës dhe dhënien e vlerësimeve të integruara mbi gjendjen e mjedisit dhe klimës së Evropës.

### Çfarë e bën AEM-Eionet unike?

- **Një rrjet i përqendruar:** tek vlera e shtuar Lidhja e institucioneve në të gjithë Evropën, ofrimi i standardeve, ndërtimi i kapaciteteve, riorganizimi si dhe shkëmbimi i praktikës më të mire.
- **Infrastruktura e të dhënave:** Infrastruktura e re e raportimit elektronik për flukset kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave, e përforcuar nga proceset e sigurimit të cilësisë.
- **Njohuri të mbështetura në të dhëna:** Përfshirja e vlerësimeve, treguesve dhe analizat e progresit për arritjen tek objektivi, duke përdorur mbledhjen më të plotë dhe më të përditësuar të të dhënave për çështjet e mjedisit dhe klimës.
- **Mbështetja e politikave:** Konsolidimi i rolit të njohurive i bazuar në bashkëpunimin e ngushtë me politikëbërësit në mbarë Evropën dhe kontribumin në proceset kryesore globale.
- **Eksptertiza analitike:** Aftësia për të vlerësuar progresin, perspektivat, nxitësit e ndryshimeve dhe reagimet e mundshme të politikës, duke mbuluar një gamë të gjerë të çështjeve të mjedisit dhe klimës.

## Duke iu përgjigjur sfidave përpara nesh

### Ndërtimi i qëndrueshmërisë kërkon politika ambicioze të mbështetura nga njohuri vepruese

Gjatë dekadës së ardhshme, Evropa do të duhet të trajtojë sfida mjedisore dhe klimatike të paprecedentë dhe në të njëjtën kohë do të duhet të stimulojë një rimëkëmbje nga ndikimet ekonomike dhe sociale të lidhura me pandeminë COVID-19. Marrëveshja e Gjellbër Evropiane dhe masat shoqëruese stimuluese të rimëkëmbjes së gjellbër, tregojnë ambiciet e Bashkimit Evropian dhe vendeve evropiane për përmbushjen e këtyre sfidave, duke vendosur objektiva afatgjata, me synime konkrete dhe duke krijuar instrumenta të rinj financiarë.

Raporti i AEM-së për Gjendjen dhe Perspektivën e Mjedisit në Evropë (SOER 2020) bëri thirrje për përgjigje sistematike ndaj mjedisit dhe sfidave të klimës, përmes veprimeve në disa fronte. Zbatimi i plotë i politikave ekzistuese mjedisore dhe klimatike është thelbësor, për të arritur përmirësime të dukshme. Gjithashtu, një integrim i plotë i objektivave të qëndrueshmërisë, në politikat dhe masat social ekonomike do të ndihmojnë në arritjen e tranzicioneve të drejta dhe kosto efektive të qëndrueshmërisë. Për më tepër, Evropa duhet gjithashtu të krijojë kushtet për stile jetese më të qëndrueshme. Kjo kërkon ndërgjegjësim më të madh publik mbi ndikimet e konsumit, si dhe angazhimin nga kompanitë për të mbështetur tranzicionet e kërkuara. Shumë objektiva nuk do të arrihen pa përpjekje të koordinuara globale, kështu që Evropa do të duhet të përdorë ndikimin e vet në fqinjësinë e saj si dhe në nivel global.


Zgjedhjet e bëra nga politikëbërësit, kompanitë dhe qytetarët gjatë dekadës së ardhshme, do të përcaktojnë kur dhe si do t'i arrijë Evropa ambiciet e veta. Strategjia e AEM-Eionet 2021-2030, do të mbështesë këto zgjedhje duke ofruar njohuri vepruese mbi trendet, perspektivat dhe zgjidhjet për një Evropë të qëndrueshme.

### Shpërthimi i madh i të dhënave

- Ajri dhe klima
- Qëndrueshmëria dhe mirëqenia
- Natyra
- Më shumë se një çështje mjedisore

Duke marrë vitin 2002 si një pikë fillestare (fillimi i Reportnet), ky vizualizim tregon rritje të qëndrueshme të të dhënave të marra për katër çështje mjedisore.

Sot ne trajtojmë afërsisht 250 herë më shumë të dhëna se në vitin 2002.



# Strategjia AEM-Eionet 2021-2030

## Sigurimi i të dhënave dhe njohurive për të arritur ambiciet mjedisore dhe klimatike të Evropës

### Çfarë duam të arrijmë: Vizioni për vitin 2030

AEM dhe Eionet do të mundësojnë një Evropë të qëndrueshme, përmes njohurive të besueshme dhe vepruese për vendim-marrje të mbështetur tek informacioni, përparësitë dhe zgjidhjet, në përputhje me ambiciet e politikës së Evropës.

### Shtirja përtej anëtarëve të Eionet

Ambicia e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane, kërkon që Evropa të punojë globalisht, me fqinjët dhe partnerët e saj. Ne do të mobilizojmë ekspertizën dhe burimet në mbështetje të këtyre ambicioneve, veçanërisht në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në vendet fqinje të afërt të Evropës.

## Ambiciet e politikës mjedisore dhe klimatike të Evropës

Trajtimi i sfidave mjedisore dhe klimatike është detyra përcaktuese e kohëve tona. Për të arritur një të ardhme të qëndrueshme, nismat politike, përfshirë edhe Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, bëjnë thirrje për veprim në drejtimet vijuese:

- Ndalimi i humbjeve të biodiversitetit dhe rivendosja e ekosistemeve
- Arritja e objektivit "zero shkarkime" të gazeve sere në 2050 dhe qëndrueshmërisë së klimës.
- Arritja e objektivit ambicioz "zero ndotje" për një mjedis pa toksina.
- Arritja e efikasiteti të burimeve në një ekonomi qarkulluese.
- Sigurimi i qëndrueshmërisë në të gjitha politikat e BE-së

Në kuadër të këtyre politikave kyçe Evropiane, ne do të luajmë një rol kryesor në mbështetje të veprimeve mjedisore dhe klimatike dhe në zbatim të Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin.

Në të njëjtën mënyrë, ne do të mbështesim përpjekjet globale, duke përfshirë Axhendën e 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe për Objektivat Zhvillimi të Qëndrueshëm.

## Si do të punojmë: Objektivat Strategjike

### OS1 Mbështetje e zbatimit të politikave dhe tranzicioneve të qëndrueshmërisë

Gjenerimi i njohurive të bazuara në prova, për të mbështetur zbatimin e politikave dhe zhvillimin e nismave të reja, për të përshpejtuar dhe përshkallëzuar tranzicionin drejt qëndrueshmërisë.

### OS2 Sigurimi i inputeve në kohën e duhur, të nevojshme për zgjidhjet dhe sfidat e qëndrueshmërisë

Ofrimi i inputeve të synuara për të informuar politikën dhe debatim publik, me anë të organizimit dhe komunikimit të njohurive mbi reagimet, duke përfshirë zgjidhje inovatore për sfidat shoqërore.

### OS3 Ndërtimi i rrjeteve dhe partneriteteve më të forta

Të forcojmë rrjetin tonë nëpërmjet angazhimit më aktiv në nivel kombëtar dhe të punojmë me organizata të tjera lider, me qëllim që të lehtësojmë shpërndarjen e njohurive dhe ekspertizës.

### OS4 Përdorimi i plotë i potencialit të të dhënave, Teknologjisë dhe dixhitalizimit

Përqafimi i dixhitalizimit, duke përfshirë teknologjitë e reja, të dhënat e rëndësishme, inteligjencën artificiale dhe vëzhgimin e tokës, të cilat do të plotësojnë dhe potencialisht të zëvendësojnë burimet e përcaktuara të informacionit me qëllim, mbështetjen më mirë të vendim-marrjes

### OS5 Sigurim burimesh për ambiciet tona të përbashkëta

Zhvillim strukturash, ekspertize dhe kapacitetesh në të gjithë rrjetin tonë, për të përbushur nevojat në zhvillim për njohuri, duke siguruar dhe diversifikuar burimet e nevojshme për të arritur vizionin tonë të përbashkët.

## Çfarë do të bëjmë: Fushat e punës

Ne do të ofrojmë njohuri vepruese në pesë fusha të punës. Sektorët e prodhimit të Evropës (duke përfshirë bujqësinë, pylltarinë, peshkimin dhe industrinë) si dhe sistemet e prodhimit dhe konsumit (energji, lëvizshmëri, ushqim dhe ndërtësata) do të adresohen përmes këtyre fushave të punës të ndërlidhura:



### Biodiversiteti dhe ekosistemet

Ballafaquar me humbjen e vazhdueshme të biodiversitetit dhe degradimin e ekosistemit, Evropa kërkon ta rikthejë natyrën në jetën tonë. Ne do të monitorojmë këtë tranzicion dhe do të mbështesim zbatimin dhe vlerësimin e veprimeve në këtë fushë, duke përfshirë zhvillimin e zgjidhjeve të bazuara tek natyra.



### Përshtatja dhe zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike

Ndryshimi i klimës po ndodh tani dhe do të vazhdojë edhe në dekadat e ardhshme. Evropa synon të arrijë neutralitetin e klimës deri në vitin 2050 dhe të bëhet më e qëndrueshme dhe më pak e ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike. Ne do të monitorojmë këtë tranzicion dhe do të mbështesim zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave në këtë drejtim.



### Shëndeti i njeriut dhe mjedisi

Ne do të vlerësojmë ndikimet në shëndetin e njeriut të shkaktuara nga ndotësit mjedisorë dhe nga ndryshimi i klimës së Evropës me qëllim që të kuptojmë me mire faktorët socialë dhe demografikë që ndikojnë në ekspozimin dhe ndjeshmërinë e qytetarëve evropian. Ne do të mbështesim ambiciet për "ndotje zero" dhe zbatimin e aksioneve Evropiane dhe kombëtare përkatëse.



### Ekonomia qarkulluese dhe përdorimi i burimeve

Ne do të monitorojmë progresin e tranzicionit të Evropës drejt një ekonomie qarkulluese dhe dobitë mjedisore dhe klimatike të përfutuara. Ne do të vlerësojmë përpjekjet e Evropës drejt zvogëlimit të ndikimeve të shkaktuara nga konsumi i shoqërisë sonë, prodhimi i lëndëve të para, produkteve, shërbimeve dhe mbeturinave.



### Trendet e qëndrueshmërisë, perspektivat dhe përgjigjet

Ne mund të arrijmë objektivat tona ambicioze, duke stimuluar ndryshime thelbësore në stilin e jetesës dhe në modelet e konsumit dhe të prodhimit, të cilat në vetvete nxisin trende të paqëndrueshme. Ne do të vlerësojmë trendet dhe perspektivat, përmes prioritetëve mjedisore, sektorëve, sistemeve dhe politikave, si dhe do të angazhohim palët e interesuara drejt inovacioneve dhe përgjigjeve të tjera të nevojshme, me qëllim arritjen e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.

# VIZIONI

## Vizioni AEM-Eionet për vitin 2030



**Mundëson një Evropë të qëndrueshme, përmes njohurive të besueshme dhe vepruese për vendimmarrje të informuar, bazuar në përparësitë dhe zgjidhjet mjedisore dhe klimatike.**

### Një vizion i përbashkët për një Evropë të qëndrueshme

Vizioni ynë është që të mundësojë një Evropë të qëndrueshme përmes njohurive të besueshme dhe vepruese për vendimmarrje të informuar, bazuar në përparësitë dhe zgjidhjet mjedisore dhe klimatike, në përputhje me ambiciet politike të Evropës.


AEM dhe Eionet do të formojnë sëbashku rrjetin kryesor të njohurive mjedisore dhe klimatike në Bashkimin Evropian dhe në nivele kombëtare.

### Misioni ynë

Misioni ynë është të vlerësojmë të dhënat dhe informacionet, me qëllim dhënien e mendimeve të duhura në kohën e duhur, mbi progresin dhe përmbushjes së synimeve të qëndrueshmërisë së mjedisit dhe klimës dhe tranzicioneve të dëshiruara shoqërore, si edhe për të siguruar monitorim të vazhdueshëm me qëllim zbatimin e plotë të politikave mjedisore dhe klimatike përkatëse.


Ne e pranojmë se ambiciet mjedisore dhe objektivat klimatike të Evropës, do të arrihen përmes një sërë vendimesh dhe zgjedhesh të ndërlidhura në nivele të ndryshme - europiane, rajonale, kombëtare dhe lokale - dhe do ta bëjnë të domosdoshme punën tonë me partnerë kryesorë dhe organizata të tjera. Në përmbushje të programeve tona të punës, ne do të punojmë në bashkëpunim të ngushtë me ofrues të tjerë të njohurive.

Për të arritur ndikim më të madh, ne do të përqëndrohemi më tej në komunikimin e synuar dhe në kohën e duhur me qëllim sigurimin e përfitimit të plotë nga vendim-marrësit dhe publiku.



# OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

## Mbështetja e zbatimit të politikave dhe e tranzicioneve të qëndrueshmërisë



### **Prodhimi i njohurive të bazuara në prova, në mbështetje të zbatimit të politikave dhe zhvillimit të politikave të reja, me qëllim përsheptimin dhe shkallëzimin e tranzicionit drejt qëndrueshmërisë**

Njohuritë tona, të bazuara në gjetjet më të fundit shkencore dhe në të dhënat e bazuara tek cilësia, do të ndihmojnë Evropën - Bashkimin Evropian, vendet e saj anëtare dhe vendet e tjera anëtare dhe bashkëpunuese të AEM - të arrijnë objektivat e tyre politike, duke përfshirë ato të identifikuar në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane, në Programin e 8-të të Veprimit për Mjedisin dhe në angazhimet globale.

Agjencia Evropiane e Mjedisit dhe Rrjeti Evropian i Informacionit dhe Vëzhgimit të Mjedisit do të:


- Prodhojë njohuri për të lehtësuar zbatimin e politikave dhe për të informuar zhvillimin e iniciativave të reja, që mund të përsheptojnë dhe përshkallëzojnë tranzicionin drejt qëndrueshmërisë
- Zhvillojë dhe përdor më tej gamën e gjerë të të dhënave cilësore dhe të shtira në kohë që ajo disponon, në mbështetje të shumë politikave mjedisore dhe klimatike
- Sigurojë përdorimin e njohurive shkencore më të mira të disponueshme me anë të angazhimit të Komitetit Shkencor të AEM dhe komunitetit të gjerë shkencor
- Zhvillojë dhe ndajë njohuritë mbi sfidat kryesore të qëndrueshmërisë dhe zgjidhjeve, nëpër gjithë sistemet e energjisë, lëvizshmërisë, ushqimit dhe ambienteve të ndërtuara
- Adresojmë sfida dhe mundësi më të mëdha të lidhura me tranzicionet e qëndrueshmërisë, si në nivel evropian ashtu edhe në atë kombëtar, duke përfshirë mundësitë e këtij ndryshimi, siç janë sektori i financave dhe qytetet
- Forcojmë kapacitetin tonë për të kontribuar në vlerësimin e politikave dhe masave që duhen ndëmarë.

Mbështetja e integritit të njohurive të mjedisit dhe klimës në politikat ekonomike, planifikimin hapësinor dhe kohezionin social - duke përfshirë njohuri më të thella në dinamikën globale të Evropës dhe implikimet e tyre për zbatimin e politikave në të gjithë Evropën - është një përparësi për këtë strategji.

Gjatë 2021-2030, ne gjithashtu do të mbështesim proceset përkatëse të politikave të BE-së të tilla si Semestri Evropian dhe Rishikimi i Zbatimit të Politikave Mjedisore me njohuri të përmirësuara, për shembull, në tendencat dhe treguesit kryesorë, në zbatimin e praktikave kosto-efekt dhe në potencialin për të rritur rritjet sociale me qëllim arritjen e objektivave të qëndrueshmërisë.

# OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

## Sigurimi i inputeve në kohë për zgjidhjet dhe sfidat e qëndrueshmërisë



**Ofrimi i inputeve të synuara, për të informuar politikën dhe diskutimet publike me anë të organizimit dhe komunikimit të njohurive mbi reagimet, duke përfshirë zgjidhje inovatore për sfidat shoqërore.**

Ndikimi dhe influenza e njohurive të EEA-Eionet, do të varen nga aftësia dhe kapaciteti ynë për të ndikuar debatin publik dhe politik, në kohën dhe formatin e duhur.


Për ta bërë këtë, ne do të:

- Rrisim kapacitetin tonë për të monitoruar dhe identifikuar problemet e shfaqura dhe mobilizuar shpejt njohuritë e rëndësishme brenda rrjetit tone, por edhe nga partnerë të tjerë
- Forcojmë kapacitetin tonë për të ofruar përgjigje të menjëhershme ndaj kërkesave për njohuri nga politikëbërësit.
- Ndajmë zgjidhje inovative të zbatuara në nivele të ndryshme të qeverisjes në vendet evropiane
- Zhvillojmë dhe shpërndajmë njohuritë tona tek politikë-bërësit dhe publiku në formatet më të përshtatshme në përputhje me nevojat e tyre në mënyrë që të lehtësojnë më shumë marrjen e vendimeve
- Zhvillojmë vazhdimisht qasjet, kanalet dhe mjetet e komunikimit, në mënyrë që të sigurojmë që njohuritë tona të jenë të kuptueshme, të disponueshme dhe të arritshme nga të gjithë, duke forcuar aftësinë tonë për t'u angazhuar në mënyrë aktive me qytetarët.

Studiuesit, zbatuesit, vendimmarrësit, donatorët, qytetet dhe organizatat e shoqërisë civile, do të punojnë së bashku përmes pjesëmarrjes aktive në proceset e tranzicionit.

# OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

## Ndërtimi i rrjeteve dhe partneriteteve më të forta



**Të forcojmë rrjetin tonë nëpërmjet angazhimit më aktiv në nivel kombëtar dhe të punojmë me organizata të tjera kryesuese, me qëllim lehtësimin e ndarjes së njohurive dhe ekspertizës.**

AEM dhe Eionet, bashkon qindra organizata - institucione evropiane, autoritete publike dhe institucione kërkimore nga e gjithë Evropa. Rrjeti ynë përfshin të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së, vendet e angazhuara në procesin e anëtarësimit në BE si dhe një numër vendesh jo-anëtare të BE-së.

Ne formojmë një rrjet unik njohurish, që lidh të dhëna të rëndësishme, ekspertizë analitike dhe shkencore për proceset e politikave evropiane dhe në disa raste dhe për ato globale. Kjo na lejon të kryejmë vlerësime të integruara, që mbulojnë gamën më të gjerë të çështjeve, të mbështetura në të dhëna dhe ekspertizë të konsoliduar.

Për të ofuar njohuritë, për të cilat Evropa ka nevojë sot për të arritur qëllimet e saj të qëndrueshmërisë, ne do të:

- Shndërrohemi në një rrjet njohurish më fleksibël dhe inovativ, që lidh më mirë ekspertizën cilësore në nivel kombëtar me atë në nivel evropian
- Nxisim angazhim më aktiv në nivel kombëtar, përmes aktiviteteve që përfshijnë një grup të larmishëm autoritetesh, organizatash dhe publikun
- Bashkojmë përpjekjet me rrjete të tjera kryesuese, të tilla si Rrjeti i Agjencive për Mbrojtjen e Mjedisit, rrjetet e raportimeve, ato shkencore si dhe shoqatat
- Identifikojmë dhe punojmë me komunitetin e njohurive në nivel Evropian, për të siguruar përdorimin e plotë të investimeve kërkimore dhe inovative në Evropë
- Identifikojmë boshllëqet e shfaqura të njohurive dhe hulumtojmë mbi veprimet bashkëpunuese me partnerët përkatës, përfshirë agjencitë e BE-së si Agjencia Evropiane e Kimikateve, Autoriteti Evropian i Sigurisë së Ushqimit dhe Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve, me qëllim adresimin e tyre
- Forcojmë më tej bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare në proceset kyçe rajonale dhe globale, duke përfshirë organet dhe Konventat e Kombeve të Bashkuara, mbi detyrimet e raportimeve dhe temat me interes të përbashkët.



# OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

## Përdorimi i plotë i potencialit të të dhënave, Teknologjisë dhe dixhitalizimit

**Të mbështesë zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të axhendes politike Evropiane, duke përqafuar strategjinë Evropiane të të dhënave dhe axhendën dixhitale, potencialin e të dhënave të shumta, inteligjencën artificiale dhe vëzhgimin e tokës, për transmetim më të mirë të informacionit**

Teknologjitë dixhitale, të dhënat nga burimet e reja dhe vëzhgimi i tokës, aftësitë informatike janë zhvilluar me një ritëm të paparë në dekadën e fundit. Këto zhvillime paraqesin mundësi dhe sfida të reja. Flukset e reja të të dhënave në nivele të shumëfishta hapësinore, gjithnjë e më shumë po inkorporohen me burime të përcaktuara të të dhënave, të lidhura me variablat socio-ekonomikë dhe me të dhënat pothuajse në kohë reale nga vëzhgimet satelitore dhe *in-situ* (në vend).

Duke pritur që ky revolucion i të dhënave dhe dixhitalizimit të vazhdojë gjatë dekadës së ardhshme, dhe me qëllim përmirësimin e punës sonë lidhur me të dhënat dhe njohuritë, ne do të:

- Intensifikojmë shpërndarjen e të dhënave, automatizimin dhe strukturimin e monitorimit dhe raportimit në të gjithë rrjetin tonë
- Të bëjmë të gjitha të dhënat tona të gjatshme, ndërvepruese, të arritshme dhe ripërdorshme, si qendra kryesore Evropiane e të dhënave për mjedisin
- Të shfrytëzojmë potencialin e plotë të të dhënave dhe shërbimeve të informacionit të Copernicus, shkencës qytetare, të dhënave të shumta dhe inteligjencës artificiale
- Të përmirësojmë afatet kohore, krahasueshmërinë, hollësitat dhe integrimin e të dhënave, përfshirë potencialin për krahasimin e tyre
- Të ofrojmë risi të vazhdueshme të bazuar në të dhëna, duke i kushtuar vëmendje avancimit në nxjerrjen e të dhënave, analitiken, sistemet e informacionit gjeografik, vizualizimet dhe modelimit të të dhënave, me qëllim përditësimin e rregullt të treguesve
- Të lehtësojmë shkëmbimin e ekspertizës, mbështetjen teknike dhe modernizimin e nevojshëm për zbatimin më të mirë të politikave ekzistuese
- Të eksplorojmë dhe, ku është e përshtatshme, të vlerësojmë ndërlidhjet midis dixhitalizimit dhe qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale.

# OBJEKTIVI STRATEGJIK 5

## Sigurim burimesh për ambiciet tona të përbashkëta



**Të Zhvillojmë strukturat, ekspertizën dhe kapacitetin në të gjithë rrjetin tonë për të përmbushur nevojat e ndryshme dhe në zhvillim të dijes, duke siguruar dhe diversifikuar burimet e nevojshme për të arritur vizionin tonë të përbashkët**

Zhvillimet e vazhdueshme në njohuri, teknologji, komunikimin dhe praktikën e menaxhimit, kërkojnë që organizatat dhe rrjetet të adaptojnë dhe përtërijnë strukturat dhe mjetet ekzistuese dhe të investojnë në fusha të reja.

Për të qenë në ballë të zhvillimeve të tilla dhe për të arritur ambiciet tona të përbashkëta, ne do të:

- Të tërheqim talentet më të mira dhe të investojmë në stafin tonë, për të zhvilluar dhe ruajtur kompetencat dhe ekspertizën e nevojshme për të realizuar vizionin që ne kemi
- Të sigurojmë një diversifikim të menaxhuar mirë, të bazës së burimeve financiare të AEM, duke mbrojtur rolin institucional dhe pavarësinë e Agjencisë
- Të kërkojmë financimin e nevojshëm për të përdorur potencialin e plotë të të dhënave Copernicus, përmes krijimit të një rrjeti të forte, me aktorë të tjerë kryesorë të cilët lidhin flukset në rritje të të dhënave me politikëbërësit
- Të zgjerojmë pjesëmarrjen e AEM dhe Eionet në projektet përkatëse kërkimore të BE, duke forcuar kështu rolin tonë në lidhjen dhe ndërveprimin e shkencës me politikën
- Të eksplorojmë mundësitë e financimit përmes instrumenteve financiare të BE-së, për të bërë të mundur që rrjeti ynë të lehtësojë zbatimin e politikave aty ku është e nevojshme dhe të mbështesë komunitetet e praktikës
- Të forcojmë kapacitetet në vendet anëtare dhe bashkëpunuese, për të siguruar që rrjeti ynë të përgjigjet nevojave dhe kërkesave në ndryshim
- Të mbështesim zhvillimin e kapaciteteve të ekspertëve dhe risive të njohurive në rrjetin tonë përmes mekanizmave të strukturuar, siç është Akademia AEM
- Të mbështesim ekspertizën e njohurive dhe kërkesave të lidhura me zbatimin e plotë të politikave mjedisore dhe klimatike të BE-së dhe legjislacionit në Ballkanin Perëndimor.

Arritja e tranzicioneve të qëndrueshmërisë, do të kërkojë që politikat e fushave të ndryshme dhe nivelet e qeverisjes të veprojnë së bashku, për të nxitur ndryshime dhe veprime në të gjithë shoqërinë. Kjo nënkupton kontribute koherente nga fusha të ndryshme të politikave, duke filluar nga kërkimi dhe inovacioni, ekonomia, industria, konkurrenca dhe tregtia, deri tek punësimi, arsimi dhe mirëqenia.



# Fushat e punës

Secili prej pesë objektivave strategjikë, do të përmbushet nëpërmjet punës sonë në gjithë fushat e përcaktuara.

AEM dhe Eionet do të luajnë një rol kyç në mbështetjen e veprimeve të mjedisit dhe klimës, në kuadrin e politikave Europiane, Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane dhe në zbatimin e Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin në veçanti, si edhe në angazhimet globale të Evropës.

Ne do t'i japim përparësi të kuptuarit të ndërlidhjeve brenda dhe ndërmjet këtyre fushave të punës. Do të trajtohen sektorë prodhimi (bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria) si edhe sistemet e prodhimit dhe konsumit (energji, lëvizshmëria, ushqimi, ndërtesat), duke përfshirë analiza në të gjithë këta sektorë dhe sisteme.

## 1 Biodiversiteti dhe ekosistemet



Ne do të informojmë dhe vlerësojmë veprimet, që kanë për qëllim mbrojtjen e biodiversitetit dhe rivendosjen e ekosistemeve për përdorimin e tyre të qëndrueshëm për të përmbushur nevojat e njerëzve. Ne do të mbështesim monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e bazuar në të dhëna, në përputhje me Strategjinë e Biodiversitetit të BE-së deri në vitin 2030 në veçanti, duke:

- Kontribuar në sistemet e monitorimit dhe vëzhgimit, që përmirësojnë fluksin e të dhënave mbi gjendjen dhe presionet në biodiversitet, ndryshimet në ekosistemet detare, ujore dhe tokësore
- Thelluar njohuritë tona mbi ndikimet kumulative të specieve të huaja invazive, ndotjes, ndryshimit të klimës dhe përdorimit intensiv dhe shfrytëzimit të tepërt të biodiversitetit, burimeve natyrore dhe ekosistemeve
- Forcuar vlerësimin tonë mbi nxitësit themelorë sistematikë që ndikojnë në biodiversitetin dhe ekosistemet
- Përmirësuar përdorimin e analitikës dhe modelimit ekologjik dhe ekonomik, duke mundësuar punën tonë vlerësuese me qëllim mbështetjen më të mirë të praktikave të menaxhimit të bazuara në ekosisteme
- Mbështetur qasjet për zgjidhje të bazuara tek natyra, duke u përqëndruar në mbrojtjen, rivendosjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve jetike, gjithashtu në kontekstin e veprimeve për zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike si dhe për bio-ekonominë
- Rritur mbështetjen tonë për zbatimin efektiv dhe koherent të strategjive të ndërlidhura të BE në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane, të tilla si "Farm to Fork" dhe "Zero Pollution" dhe politikat e tyre shoqëruese, ndërkohë që vazhdojmë punën për integrimin e biodiversitetit në të gjithë sektorët ekonomikë dhe ato të varura nga natyra, të tilla si ushqimi.

## 2 Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja



Ne do të monitorojmë progresin e Evropës në drejtim të neutralitetit dhe rezistencës së klimës, do të mbështesim zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave përkatëse dhe masave shoqëruese, në kontekstin e objektivave më të gjera të qëndrueshmërisë së Evropës me anë të:

- Mbledhjes, kontrollit të cilësisë, përpilimit dhe raportimit të të dhënave dhe informacioneve përkatëse mbi emetimet e gazeve serë, si dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike, cënueshmërisë dhe përshtatjes në Evropë
- Analizimin dhe vlerësimin e këtyre të dhënave, në lidhje me objektivat dhe angazhimet europiane dhe kombëtare për zbutjen dhe përshtatjen
- Monitorimin e zbatimit dhe efektet e politikave kombëtare të lidhura me klimën dhe masat shoqëruese, që synojnë sektorë të tillë si energjia, transporti, ndërtimi, bujqësia, pylltaria dhe përdorime të tjera të tokës
- Identifikimi i sinergjive dhe shkëmbimeve të politikave të zbutjes dhe përshtatjes së klimës me çështje të tjera mjedisore, të tilla si biodiversiteti, ndotja e ajrit, ujërave të ëmbla dhe mjedisit detar
- Zhvillimit të njohurive mbi zgjidhjet për të adresuar sfidat e mjedisit dhe të qëndrueshmërisë në sistemet e energjisë dhe lëvizshmërisë.

## 3 Shëndeti i njeriut dhe mjedisi



Ne do të vlerësojmë ndikimet në shëndet, të shkaktuara nga ndotja e ajrit, tokës dhe ujit, zhurma, kimikatet dhe ndryshimi i klimës në Evropë. Ne do të mbështesim ambicien europiane të ndotjes zero, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e veprimeve përkatëse europiane dhe kombëtare me anë të:

- Vlerësimin të shkallës së ekspozimit dhe ndikimeve në shëndetin e qytetarëve të ekspozuar ndaj ndotjes së mjedisit, kimikateve dhe ndryshimeve klimatike në Evropë
- Vlerësimin të përfitimeve në shëndet dhe mirëqenien e njeriut, të cilat mund të sigurohen nga një mjedis më i pastër dhe ekosisteme të shëndetshme, dhe anasjelltas identifikimin e rreziqeve të reja dhe ndikimeve në shëndet, që lidhen me degradimin e ekosistemit
- Mbështetjes së raportimit, përpunimit dhe shpërndarjes në kohë të të dhënave dhe informacioneve tematike të raportuara sipas legjisllacionit përkatës dhe monitorimit të progresit në drejtim të arritjes së objektivave politike të Evropës
- Identifikimi i ndikimeve që presionet nga sektorët dhe sistemet socio-ekonomike të Evropës kanë mbi shëndetin, dhe përfitimet që mund të sjellin veprimet dhe politikat zbutëse
- Theksimi i mëtejshëm i rolit që faktorët socialë, përfshirë pabarazitë shoqërore dhe sjelljet individuale, mund të luajnë, duke ndikuar si në ekspozimin ashtu edhe në cënueshmërinë ndaj presioneve mjedisore, në përputhje me parimet e tranzicionit të drejtë të Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane.

## 4 Ekonomia qarkulluese dhe përdorimi i burimeve



Ne do të vlerësojmë progresin e tranzicionit Evropian drejt një ekonomie qarkulluese dhe njohuritë tona për mjedisin dhe presionet klimatike të shkaktuara nga prodhimi dhe konsumi i lëndëve të para, produkteve, shërbimeve dhe mbeturinave në Evropë. Ne do të mbështesim, zbatimin e Planit të Veprimit të Ekonomisë Qarkulluese dhe politikat përkatëse Evropiane dhe kombëtare me anë të:

- Vlerësimin të progresit të tranzicionit të Evropës, nga një ekonomi lineare në një ekonomi qarkulluese, me theks tek zinxhirët kryesorë të vlerës së produktit, shërbimeve inovative dhe modeleve të biznesit.
- Theksimit të mundësive për të përmirësuar qarkullimin, duke përfshirë riciklimin dhe ripërdorimin e lëndëve të para dytësore, miratimin e parimeve të sigurta dhe të qëndrueshme të dizajnit, eko-inovacionin dhe praktikat e mira, si dhe identifikimin e pengesave drejt qarkullimit më të madh.
- Monitorimit të progresit në arritjen e objektivave të politikave Evropiane për parandalimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.
- Vlerësimin e ndikimeve në mjedis dhe klimë, të sistemeve Evropiane të prodhimit dhe konsumit nga perspektivat europiane dhe me fokus në sektorët intensiv të burimeve, si dhe në ndërlidhjet midis ekonomisë, qarkulluese nismave të dekarbonizimit dhe bio-ekonomisë seoste.

## 5 Trendet e Qëndrueshmërisë, perspektivat dhe përgjigjet



Ne do të ushqejmë diskutimet në lidhje me sfidat e qëndrueshmërisë dhe tranzicionet, duke vlerësuar sinergjitë dhe shkëmbimet tregtare të qenësishme për të ekuilibruar njëkohësisht mjedisin, objektivat ekonomikë dhe socialë me anë të:

- Vlerësimin të tendencave dhe perspektivave për qëndrueshmëri në Evropë dhe globalisht përmes prioriteteve të mjedisit dhe klimës, sektorëve, sistemeve dhe politikave në mbështetje të raporteve të gjëndjes dhe perspektivës së mjedisit të Evropës 2025 dhe 2030
- Mbështetjes së kornizave të monitorimit të bazuara në tregues, që informojnë progresin përmes prioriteteve të politikave të BE-së, në veçanti PVM e 8-të Programit të 8-të të Veprimit për Mjedisin, Rishikimin e Zbatimit të Mjedisit, Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane
- Kontribut, së bashku me vendet, në monitorimin dhe vlerësimin, e progresit, përmes prioriteteve mjedisore dhe klimatike, sipas Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Vlerësimin të ndërvarësisë ndërmjet dimensioneve të qëndrueshmërisë së qeverisjes socio-ekonomike-mjedisore, përfshirë nxitësit e ndryshimit, sinergjitë pozitive dhe efektet e jashtme negative
- Angazhimin me partnerët kryesorë, në parashikimet përkatëse strategjike të BE-së dhe proceset e palëve me qëllim grumbullimin e informacionit dhe njohurive vepruese, mbi rrugët nga tranzicionet drejt qëndrueshmërisë
- Mbështetjes së zhvillimit të njohurive mbi tranzicionet e sistemeve të tilla si sinergjitë, rreziqet, inovacionet, integrimi i politikave dhe koherenca e politikave - me theks tek qytetet dhe sektori i financave.
- Vlerësimin sesi financat e qëndrueshme mund të stimulojnë përpjekjet për të arritur qëndrueshmëri brenda kornizës së planeve të rimëkëmbjes post-pandemike dhe një konteksti makroekonomik në ndryshim.

## Fushat e punës

